



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

VENDIM

Nr. 19, datë 18.01.2024

PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE NË PROCEDURËN E LËVIZJES PARALELE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 12, DATË 18.01.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me datë 18.01.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes, me projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, si dhe me Relacionin përkatës mbi këtë projektvendim, përgatitur nga relatori i procedurës së përzgjedhjes z. Klodian Kurushi,

V Ë R E N

I. TË DHËNA MBI PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES

1. Me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor (*më poshtë referuar si Këshilli*) hapi katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 11, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
2. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.02.2023.
3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 11 datë 18.01.2023 (*më poshtë referuar si vendimi 11/2023*), kandiduan gjithsej 7(shtatë) kandidatë, sipas tabelës së mëposhtme:

Pozicioni	Nr	Vendimi nr.11
1		{...} Gj.JP Korçë
2		{...} Gj.JP Korçë – komanduar në GjLartë

3	{...} Gj.JP Lezhë
4	{...} Gj.JP Dibër
5	{...} GJ.JP Durrës
6	{...} Gj.JP Lezhë
7	{...} Gj.JP Gjirokastrë

4. Pas përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 11/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë janë përfshirë këta kandidatë sipas vendimeve respektive:

Pozicioni	Nr	Vendimi nr.11
1		{...} Gj.JP Lezhë
2		{...} Gj.JP Dibër
3		{...} Gj.JP Durrës

5. Në vijim, me vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, Këshilli ka vendosur: *“I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11...;..datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime. II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat.*
6. Sipas pikës 7, të nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), në një procedurë lëvizje paralele për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve *që përmbushin kriteret*, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të transferohet nëpërmjet mekanizmit të lëvizjes paralele Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në pozicionin e lirë të shpallur më parë nga Këshilli.
7. Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në rastin konkret, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga 2 (dy) prej kandidatëve të kriterëve të

mëposhtme (pasi z. {...} u tërhoq nga kandidimi i tij për pozicionet e shpallura me vendimet nr.11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2013).¹

- 1) **“përvojës profesionale minimale”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast se gjatë pesë viteve të fundit nuk ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë ...”*;
- 2) **“mospasjes masë disiplinore në fuqi”**, sipas pikës 6, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“6. Magjistrati nuk ka të drejtë të kandidojë në rast seka në fuqi një masë disiplinore”*;
- 3) **“mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”**, sipas nenit 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“1. Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë. 2. Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë. 3. Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni; ... 5. Për efekt të zbatimit të kësaj dispozite, magjistrati, në momentin e paraqitjes së kërkesës për ... transferim, paraqet një vetëdeklarim përpara Këshillit, ku deklaron nëse ndodhet apo jo në një nga rastet e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni. ...”*;

8. Kandidatët e kualifikuar sipas pozicioneve që kanë aplikuar janë:

8.1 Z. {...} që aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë. Në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin e kriterëve të kandidimit për z. {...}. Këshilli, me Vendimin nr. 202, datë 26.04.2023, vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Durrës, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr.11 dhe nr. 24 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹ Këshilli me vendimin nr. 189, datë 25.04.2023 ka vendosur: *“Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione”*.

8.2 Z. {...} që aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Dibër. Në përfundim të fazës së parë të lëvizjes paralele në përputhje me parashikimet e Kreut V të vendimit 320/2020 Këshilli verifikoi plotësimin e kriterëve të kandidimit për z. {...}. Këshilli, me Vendimin nr. 181, datë 25.04.2023, vendosi kualifikimin e tij dhe vijimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11 dhe nr. 12 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Siç u parashtrua, krahas procedurave të verifikimit të kriterëve të kandidimit, paralelisht për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional. Duke qenë se kandidatët përfshihen në listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime për ta ishte e nevojshme përfundimi i vlerësimeve, konkretisht: 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar) ose për gjyqtarët që nuk e kanë kaluar këtë proces, vlerësim i parë do të konsiderohet vlerësimi i fundit etik dhe profesional që ka qenë në fuqi përpara Ligjit për Statusin; dhe 2) vlerësimi i 2-të, në mënyrë alternative si vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2022, (nëse ata nuk janë përfshirë në programet e vlerësimit periodik të miratuara nga Këshilli (*vlerësimi 3/vjeçar 2017-2019* ose vlerësim i përshpejtuar vitit kalendarik 2021).

10. Me kualifikimin e kandidatëve në pozicionin respektiv nr. 11, bazuar në pikën 75 Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 19.02.2020, "*Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve*," (më poshtë referuar si Vendimi 320/2020), Këshilli me Vendimin nr. 294, datë 30.05.2023, vendosi fillimin e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë edhe për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 11 datë 18.01.2023. Me këtë vendim, si relator i procedurës së përzgjedhjes u caktua Kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Klodian Kurushi.

11. Më datë 30.05.2023, në rrugë elektronike, në zbatim të pikës 75 e vijuese të Vendimit të Këshillit nr. 320, datë 17.09.2020, "*Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve*", kandidatët e kualifikuar u njoftuan për fillimin e procedurave të përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, si dhe për caktimin e relatorit. Kandidatët nuk paraqitën kundërshtime ose kërkesa për përjashtimin e relatorit apo për ndonjë nga anëtarët e tjerë të Këshillit.

12. Në zbatim të pikës 106, të Vendimit të Këshillit 320/2020, relatori administroi dokumentacionin përkatës për kandidatët e kualifikuar, që gjendeshin në dosjet e tyre personale apo në praktikën dokumentare të procedurave të verifikimit të plotësimin të kriterëve të kandidimit. Relatori administroi në të njëjtën kohë edhe vendimet përkatëse të Këshillit në lidhje me dy vlerësimet etike dhe profesionale për kandidatët e kualifikuar.

13. Konkretisht, lidhur me vlerësimet etike dhe profesionale, për kandidatët u konstatua se:

13.1 Për kandidatin z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, ai ka dy vlerësime etike –profesionale, konkretisht vlerësimin e gradimit (përcaktim i nivelit të vlerësimit) për periudhën 2013-2016 dhe një vlerësim të dy-të 3/vjeçar, për periudhën e vlerësimit 2017-2019. Të dy këto vlerësime janë në nivelin e vlerësimit “*shumë mirë*”, siç do të trajtohet në vijim.

13.2 Për kandidatin z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gradimi nuk mund të realizohet nga Këshilli, pasi Komisionit i Pavarur i Kualifikimit me vendimin e ndërmjetëm nr. 5 dt. 24.07.2020 i ka dhënë atij masën disiplinore të *pezullimit nga detyra për një periudhë 1-vjeçare* me detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Ky vendim i paankimueshëm e bëri të pamundur realizimin e procesit të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarin², i cili për periudhën e vlerësimit 2013-2016 nga organi kushtetues Komisioni i Pavarur i Kualifikimit që e ka këtë kompetencë, është vlerësuar se nuk ka arritur nivelin minimal profesional, mbi të cilin Këshilli mund të përcaktojë gradën (nivelin) e vlerësimit. Ky vlerësim i KPK-së, për efekt të niveleve të vlerësimit të përcaktuar në nenin 78 pika 1 të Ligjit “Për Statusin” barazohet me nivelin “*e pamjaftueshëm*”. Nga ana tjetër, vlerësimi i fundit etik-profesional që ky gjyqtar ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit “Për Statusin”, është ai i miratuar me vendimin Nr. 110/2 dt. 13.11.2015 të ish/KLD-së për periudhën e vlerësimit 2007-2009 në nivelin “*shumë mirë*”. Por për këtë gjyqtar organet e rivlerësimit kalimtar e kanë shtrirë periudhën e rivlerësimit të aftësive profesionale nga 01.01.2006 deri në tetor 2016, duke u vlerësuar se nuk arrin nivelin minimal profesional. Në vijim ky gjyqtar ka ndjekur vitin akademik pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2020-2021, sipas kurikulave të miratuara për programin teorik e praktik, në përfundim të së cilit është vlerësuar në nivelin “Mirë” duke i kaluar mangësitë e parashtruara nga KPK. Vlerësimi përfundimtar në nivelin “Mirë” është miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin Nr. 20 dt. 15.07.2021. Ky vlerësim i është përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe është rimarrë në shqyrtim nga KPK, e cila me vendimin Nr. 444 dt. 16.09.2021 ka konfirmuar në detyrë gjyqtarin, ku për kriterin e aftësisë profesionale ka pranuar vlerësimin e bërë nga Shkolla e Magjistraturës. Në këto kushte ky nivel vlerësimi “*Mirë*” i miratuar nga organi kompetent, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, përbën vlerësimin e dytë për z. {...}.

13.3 Për kandidatin z. {...}

a) Sipas Vendimit të KLGj, nr. 306, datë 06.06.2023 kandidati është vlerësuar për periudhën 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm “*Shumë mirë*”, duke grumbulluar në total 365 pikë, sipas “Raportit

² Me vendimin nr. 74, datë 13.02.2023 Këshilli ka vendosur: “Përfundimin pa një vendim përfundimtar të procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelin të vlerësimit (gradimit) të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016, për shkak se vijimi i tij rezultoi i pamundur pasi gjyqtari nuk ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën e vlerësimit.

të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

b) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 708, datë 04.12.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”, duke grumbulluar në total 371 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

13.4 Për kandidatin z. {...}

a) Sipas Vendimit të KLD nr. 110/2 datë 13.11.2015, kandidati është vlerësuar për periudhën 2007-2009, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”.

b) Sipas Vendimit të Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 20, datë 15.7.2021, i konfirmuar edhe nga vendimi i KPK, datë nr. 444, datë 16.09.2021 konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur rezultatin “mirë”.

14. Vlerësimet etike dhe profesionale të kandidatëve janë vendime përfundimtare.

15. Konkretisht për vlerësimet e z. {...}: i) Vendimi i Këshillit nr. 306, datë 06.06.2023 është vendim i formës së prerë pasi ndaj tij nuk është ushtruar ankim; vendimi i Këshillit nr. 708, datë 04.12.2023, për periudhën e vlerësimit 2017-2019 është vendim i formës së prerë sipas deklaratës së kandidatit nëpërmjet postës elektronike më datë 06.12.2023, pasi ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga kandidati.

16. Për vlerësimet e z. {...}: i) Vendimi i KLD nr. 110/2 datë 13.11.2015 është i formës së prerë; ii) Ky gjyqtar, për shkak të vendimmarrjes të ndërmjetme të KPK ka ndjekur vitin akademik pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën 2020-2021, sipas kurikulave të miratuara për programin teorik e praktik, në përfundim të së cilit është vlerësuar në nivelin “Mirë” duke i kaluar mangësitë e parashtruara nga KPK. Vlerësimi përfundimtar në nivelin “Mirë” është miratuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin Nr. 20 dt. 15.07.2021. Vendimi nr. 20, datë 15.7.2021, i Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës i konfirmuar edhe nga vendimi i KPK, datë nr. 444, datë 16.09.2021. Ky vlerësim i është përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit e vëzhguesve ndërkombëtarë

dhe është rimarrë në shqyrtim nga KPK, e cila me vendimin Nr. 444 dt. 16.09.2021 ka konfirmuar në detyrë gjyqtarin, ku për kriterin e aftësisë profesionale ka pranuar vlerësimin në nivelin “Mirë” të bërë nga Shkolla e Magjistraturës.

17. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (*Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve*), të Vendimit 320/2020, relatori realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur nga Këshilli për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë.
18. Lidhur me renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë pika 7, e Nenit 43 të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“7. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin magjistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke përfshirë edhe ato si magjistrat i komanduar, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara si magjistrat në skemën e delegimit, që i ka mbaruar afati i caktimit ose delegimit, si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vjet përpara kandidimit, si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, si anëtar i Kolegjit Zgjedhor që i ka mbaruar mandati ose çdo pozicion tjetër që ligji e përcakton si vlerë të shtuar, do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë magjistratëve me të njëjtën nivel vlerësimi, magjistratët brenda grupit të magjistratëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshillat. b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se një magjistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magjistratë sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “b”, të pikës 7, të këtij neni, ka më shumë se një magjistrat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta magjistratë sipas vjetërsisë si magjistrat.*
19. Po ashtu, për renditjen e kandidatëve u mbajtën në konsideratë hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve, sipas përcaktimeve të Vendimit 320/2020, dalë në zbatim të pikës 12, të nenit 43, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“79. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me vlerësimet më të larta etike dhe profesional, renditet më lart”.*

II. RENDITJA E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 11, DATË 18.01.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

20. Në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 11, datë 18.01.2023, u përfshinë dy kandidatë, konkretisht: z. {...} dhe z. {...}. Për këta kandidatë u verifikua plotësimi i dy kërkesave të ligjit për të qenë pjesë e procedurës së përzgjedhjes për këtë pozicion të lirë, në kushtet kur ata ishin kualifikuar në procedurën e lëvizjes paralele ndërsa plotësonin kriteret e kandidimit, si dhe kishin dy vlerësime etike dhe profesionale, sikurse kërkohet për efekt renditje nga shkronja “a”, pika 7, e nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe përcaktohet në pikën 79, të Vendimit 320/2020.

21. Për renditjen e kandidatëve, fillimisht u ndoq hapi i parë i renditjes, ku për secilin kandidat u bë një vlerësim krahasues i treguesve të kriterëve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 7, shkronja “a”, të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara në Seksionin B.1, Kreu VI, të Vendimit 320/2020.

22. Siç u parashtrua, edhe më sipër, sipas për caktimeve të pikës 7, të nenit 43, të Ligjit për Statusin dhe pikës 79, të Vendimit 320/2020 ku parashikohet se: *“Këshillat shqyrtojnë kandidatimet dhe rendisin magjistratët që përmbushin kërkesat, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, ...”*.

22.1 Referuar kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas *“niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale”*, për kandidatët u konstatua:

22.2 Për kandidatin z. {...}

a) Sipas Vendimit të KLGj, nr. 306, datë 06.06.2023 kandidati është vlerësuar për periudhën 2013-2016, në nivelin e përgjithshëm *“Shumë mirë”*, duke grumbulluar në total 365 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

b) Sipas Vendimit të Këshillit nr. 708, datë 04.12.2023, kandidati është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm *“Shumë mirë”*, duke grumbulluar në total 371 pikë, sipas “Raportit të vlerësimit etik dhe profesional” të miratuar me këtë vendim.

22.3 Për kandidatin z. {...}

a) Sipas Vendimit të KLD nr. 110/2 datë 13.11.2015, kandidati është vlerësuar për periudhën 2007-2009, në nivelin e përgjithshëm *“Shumë mirë”*. Sipas pikës 117 germa “b” të vendimit nr. 320/2020 të KLGJ-së konvertimi i nivelit të vlerësimit sipas sistemeve të mëparshme të vlerësimit etik dhe profesional, me ato sipas sistemit të vlerësimit në fuqi (Ligji për Statusin) realizohet sipas rendit ku niveli i vlerësimit *“shumë mirë”* sipas sistemit të mëparshëm të

vlerësimit etik dhe profesional barazohet me nivelin e vlerësimit “*shkëlqyeshëm*” sipas sistemit të vlerësimit etik dhe profesional në fuqi (Ligji për Statusin). Në këtë rast vlerësimi etik dhe profesional i vendosur nga KLD për këtë kandidat në nivelin “*shumë mirë*” konvertohet në nivelin “*shkëlqyeshëm*” nga Këshilli mbështetur në pikën 117 germa “b” të vendimit nr. 320/2020 të KLGJ-së.

b) Sipas Vendimit të Këshilli Pedagogjik si dhe Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, datë 15.7.2021, konstatohet se subjekti i rivlerësimit {...} ka arritur rezultatin “*mirë*”. Ky rezultat përfaqëson edhe nivelin e vlerësimit “*Mirë*” që ka marrë kandidati për periudhën e dytë të vlerësimit etik dhe profesional që përfshin vitin akademik në Shkollën e Magjistraturës 2020 – 2021.

23. Nga zbatimi i kriterit të parë të renditjes, pra atij sipas “*niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale*”, rezultoi që kandidati z. Arapi, të ketë “*Shumë mirë*” dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale të kryera nga Këshilli për efekt të gradimit dhe vlerësimit periodik 2017-2019. Kurse kandidati z. Çupi dy nivelet e vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale i ka “*Shumë mirë*” – vlerësim i bërë nga ish KLD për periudhën e vlerësimit 2007-2009 i konvertuar në “*Shkëlqyeshëm*” dhe “*Mirë*” gjatë vitit 2020 - 2021 nga Shkolla e Magjistraturës, vendimmarrje kjo e detyrueshme pas vlerësimit të KPK-së, e cila konkludoi se nuk arrin nivelin minimal profesional për periudhën 2006-2016. Nivelet e vlerësimit sipas pikës 1, të nenit 78, të Ligjit për Statusin janë sipas këtyre niveleve: a) “*Shkëlqyeshëm*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi shumë të larta; b) “*Shumë mirë*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mbi mesataren; c) “*Mirë*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi mesatare; ç) “*Mjaftueshëm*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi nën mesataren. d) “*I pamjaftueshëm*”, në rastin e vlerësimit etik dhe profesional me cilësi të dobët. Nga vlerësimi krahasues i niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale për kandidatët, duke pasur parasysh pesë nivelet e vlerësimit, identifikohet kandidati me rezultatet më të larta. Për pasojë, renditja e kandidatëve mund të bëhet sipas kësaj përparësie.

24. Renditja e kandidatëve bëhet duke krahasuar të dy nivelet e vlerësimeve për secilin prej tyre. Vlen të theksojmë se në përcaktimin e renditjes në këtë rast asnjë nga nivelet e vlerësimit për

secilin kandidat nuk përputhet me njëri – tjetrin. Kandidati z. {...} është vlerësuar me konvertim në nivelin “Shkëlqyeshëm” për periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në vitet 2007 – 2009 dhe nivelin “Mirë” nga Shkolla e Magjistraturës për vitin akademik 2020 – 2021. Kandidati z. {...} është vlerësuar në nivelin “Shumë mirë” nga Këshilli për periudhën e vlerësimit etik dhe profesional (gradimi) për vitet 2013 – 2016 dhe sërish në nivelin *Shumë mirë* nga Këshilli për periudhën e vlerësimit etik dhe profesional në vitet 2017 – 2019.

25. Ndodhur përpara situatës ku asnjë nivel vlerësimi për kandidatët nuk është i njëjtë, renditja e kandidatëve mbështetur në nenin 43 germa “a” dhe në pikën 79 të Vendimit të KLGJ nr. 320/2020 do të bazohet në vlerësimet krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të marra së bashku për secilin kandidat. Dy nivelet e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin z. {...} janë “Shkëlqyeshëm” vlerësimi i parë dhe “Mirë” vlerësimi i dytë. Rezultati i vlerësimit mesatar i të dy niveleve të vlerësimit për kandidatin z. {...} është “Shumë mirë”.
26. Dy nivelet e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatin e dytë z. {...} janë “Shumë mirë” vlerësimi i parë dhe “Shumë mirë” vlerësimi i dytë. Rezultati i vlerësimit mesatar i të dy niveleve të vlerësimit për kandidatin z. {...} është “Shumë mirë”.
27. Meqenëse të dy kandidatët kanë rezultate të njëjta në vlerësimin mesatar të të dy niveleve të vlerësimit, për renditjen e tyre në këtë rast zbatohen përparësitë e parashikuara nga pika 81 e Vendimit të KLGJ-së nr. 320/2020. Sipas pikës 81 të këtij vendimi kur rezultatet janë të njëjta në nivele vlerësimi, zbatohen për më tej përparësitë sipas radhës si vijon: a) “niveli i vlerësimi i fundit” – Sipas kësaj përparësie kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart; b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose i anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart; c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemë delegimi ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja renditet më lart; ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” – Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja renditet më lart.
28. Në këtë rast kur rezultatet në vlerësimin mesatar të të dy niveleve të vlerësimit janë të njëjta për renditjen e kandidatëve zbatohet përparësia e parashikuar nga pika 81 germa “a” e vendimit të KLGJ-së nr. 320/2020 sipas të cilit për të renditur kandidatët përparësi merr kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional. Për kandidatin z. {...} niveli i vlerësimit të fundit është niveli “Mirë” që përfshin periudhën e vlerësimit të viti akademik 2020 – 2021 të bërë nga Shkolla e Magjistraturës. Për kandidatin z. {...} niveli i vlerësimit të fundit etik dhe profesional është niveli “Shumë mirë” që përfshin periudhën e vlerësimit për vitet 2017 – 2019 të bërë nga Këshilli.

29. Mbi këtë bazë arrihet të bëhet renditja e kandidatëve, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 11, datë 18.01.2023, ku më lart renditet kandidati z. {...} me vlerësimin e fundit etik dhe profesional në nivelin “Shumë mirë”, ndërsa kandidati tjetër z. {...} renditet pas tij për shkak të vlerësimit të fundit të tij në nivelin “Mirë”. Meqenëse pas këtij hapi arrihet të përzgjidhet kandidati që renditet i pari referuar kritereve të nivelit të vlerësimit, vijimi i hapave të tjerë të renditjes është i panevojshëm.

30. Për pasojë, renditja e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 11, datë 18.01.2023, rezulton si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Z. {...};

31. Bazuar në sa përcaktohet në pikat 23-29 të këtij vendimi, sikundër edhe në rezultatin e renditjes sipas pikës 30 të tij, relatori përgatiti projektvendimin “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

32. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” u shqyrtua nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në mbledhjen e datës 26.12.2023, sikurse përcaktohet në Seksionin DH, Kreu VI, të Vendimit 320/2020, ku pasi ka konstatuar si të plotë dokumentacionin e administruar për kandidatët në këtë procedurë përzgjedhjeje, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

III. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

33. Projektvendimi “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” si dhe materialet e administruara në kuadër të procedurës së përzgjedhjes, iu nënshtruan shqyrtimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas përcaktimeve të bëra në Kreun VI, të Vendimit 320/2020.

34. Gjatë shqyrtimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi si të plota veprimet procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori, ashtu sikundër edhe të dokumentacionit të administruar për kandidatët në funksion të procedurës së përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 11, datë 18.01.2023, të Këshillit.

IV. KONKLUZIONI

35. Mbi sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerësoi se ishte rasti për miratimin pa ndryshime të projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e

Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 11, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”,

VENDOSI:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 11, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};
2. Z. {...}

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatëve z. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR